

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi historik për çlirimtarët, gjyqtarët që kanë në dorë fatin e Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/kosova/vendimi-historik-per-clirimtare-gjyqtaret-qe-kane-ne-dore-fa-i1185123
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 16:08:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 16:04:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	06f9ae657dce6461c53d319f69abc47d982c6c1541509f139fdda7a9c28b113a
TEKSTI	3790b6a71553a876f4aa60de9e620bb9789b5dd012325931e9ab537700d6e6af
PAMJA	94d789bed6bb0c441187c19de3342d649d04948fee37e6670301d86f64446ecc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	68dc24c5ffac4b3536c74ba58ee1a86c92aa8abeddb744319dbf787739a96224
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	732ea03e09e76f3f4c4f7148212f99ed57cacfcbea6b7c5016ac103a159e81ab
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/68dc24c5ffac4b3536c74ba58ee1a86c92aa8abeddb744319dbf787739a96224>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Vendimi historik për çlirimtarët, gjyqtarët që kanë në dorë fatin e Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit



Nga Erjon Dervishi
15 Shtator 2026, 18:04 | Kosova



Pas më shumë se tri vitesh gjykim dhe pas shqyrtimit të një materiali të gjerë provues, Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë pritet të shpallin më 16 shtator 2026 aktgjykimin në çështjen ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryetarëve të Kuvendit, Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, dhe ish-deputetit, Rexhep Selimi.

Shpallja e aktgjykimit është caktuar për orën 10:00 të mërkurën.

Seanca, që do të jetë publike dhe do të transmetohet në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe, kësaj radhe ka transmetim më të shpejtë se zakonisht, kur ishte me vonesë prej 45 minutash, meqenëse tani ka për t'u deklaruar vetëm verdikti.

Sipas njoftimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, të gjithë personat të cilëve u është caktuar vend në galerinë publike, në qendrën e medias apo në dhomat e informimit janë njoftuar përmes postës elektronike lidhur me pjesëmarrjen në hapësirat e gjykatës.

Ndërkohë, janë mësuar edhe tre gjyqtarët e Trupit Gjykses II, të cilët do të vulosin fatin e personave në fjalë. Konkretisht, mësohet se bëhet fjalë për amerikanin Charles L. Smith III, gjermanin Christoph Barthe dhe zviceranin Guénaél Mettraux.

Po ashtu, bëhet me dije se gjyqtari irlandez Fergal Gaynor është pjesë e panelit në cilësinë e gjyqtarit rezervë, i cili nuk jep mendim për vendimet e panelit, përveç rastit kur caktohet për të zëvendësuar një nga gjyqtarët e rregullt.

Gjyqtari amerikan Charles L. Smith III është kryesues i Trupit Gjykses II dhe zëvendëspresident i Dhomave të Specializuara. Smith ka një lidhje të mëhershme me sistemin e drejtësisë në Kosovë. Nga viti 2010 deri më 2013 ka shërbyer si gjyqtar i EULEX-it, ndërsa nga viti 2011 deri më 2013 ishte edhe anëtar i Gjykatës Supreme të Kosovës.

Christoph Barthe, eksperti gjerman i krimeve të luftës, është jurist gjerman me përvojë të gjatë në të drejtën penale dhe ndërkombëtare. Ai ka shërbyer si prokuror pranë Gjykatës Federale të Drejtësisë të Gjermanisë dhe është marrë me ndjekjen e krimeve të luftës dhe gjenocidit.

Guénaél Mettraux, gjyqtari zviceran me përvojë ndërkombëtare. Ai ka punuar në raste para Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, Tribunalit Special për Libanin, Dhomave të Jashtëzakonshme në Kamboxhia dhe Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

Irlandezi Fergal Gaynor është gjyqtari i katërt që ka ndjekur procesin, por në cilësinë e gjyqtarit rezervë. Ai nuk merr pjesë në votimin për aktgjykimin, përveç nëse caktohet zyrtarisht për të zëvendësuar një nga gjyqtarët e rregullt.

TE FUNDIT

🕒 Karakaçi inspekton punimet për bypassin e Elbasanit: I jep zgjidhje trafikut

Atentat brenda burgut, Gjykata e Lartë urdhëron rigjykimin e Ergys Kolaverit

🕒 "Do të dyfishohet bonusi për pensionistët" nga rritja nuk përfitojnë të gjithë, përjashtohen pensionet "e larta"

Sa i kushtoi Kosovës mbrojtja e të akuzuarve në Hagë?

MË TË VIZITUARAT

Gjykata Ia në burg Veliajn, Rama: Tirana sërish pa kokë, banorët po paguajnë ...

Politikanët në "darët" e SPAK, Gjykata e Lartë nuk liron Erion Veliajn, GJKKO...

Goditet grupi shqiptar i kokainës, 8 të ndaluar në Belgjikë, i përfshirë edhe...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Roli i Panelit është vendimtar: gjyqtarët duhet të vlerësojnë provat e paraqitura gjatë procesit dhe të përcaktojnë nëse Prokuroria ka arritur të dëshmojë fajësinë e secilit prej katër të akuzuarve përtej dyshimit të arsyeshëm. Të katër ish-krerët e UÇK-së i kanë mohuar akuzat dhe janë deklaruar të pafajshëm.

Vendimi i së mërkurës pritet të jetë një nga momentet më të rëndësishme të procesit gjyqësor, që ka zgjatur më shumë se pesë vjet dhe që ka nxitur reagime të shumta në Kosovë. Në rast të një aktgjykimi fajësues, çështja nuk përfundon domosdoshmërisht me shpalljen e vendimit, pasi palët kanë të drejtë të apelojnë. Ndërkaq, në rast të një vendimi lirues, Prokuroria gjithashtu mund të përdorë mekanizmat e paraparë ligjorë për ankimim.

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi përballen me akuzën për krime kundër njerëzimit dhe për krime lufte. Në mesin e akuzave janë përndjekja, burgosja, aktet e tjera çnjerëzore, tortura, vrasja dhe zhdukja me forcë, si dhe arrestimi dhe ndalimi i paligjshëm e arbitrar, trajtimi mizor, tortura dhe vrasja si krime lufte.

Të katër të akuzuarit pretendohet nga Prokuroria se mbajnë përgjegjësi individuale penale në forma të ndryshme të përgjegjësisë. Ata janë deklaruar të pafajshëm dhe mbrojtja ka kundërshtuar akuzat e Prokurorisë.

Në krye të Zyrës së Prokurorit të Specializuar është Kimberly West, Prokurorja e Specializuar e tretë e kësaj gjykate. Në çështjen Thaçi dhe të tjerët, ekipi kryesor i Zyrës së Prokurorit të Specializuar përbëhet nga: Alan Tieger, Clare Lawson, Nathan Quick.

(A2 Televizion)

A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Votime, grindje dhe krizë pa fund, Kuvendi vijon të dielën, PDK heq dorë dhe pret Kushtetuesen



Reagon OVL e UÇK: Nuk fshihet dot dështimi i një prokurorie të njëanshme!



"Prokuroria nuk është e aartë". Avokatia:



Noërci për Presidentin e ri. Kurti

ZVP nuk ka provë për ndërhyrjen e Thaçit përallajmëron të tjera takime me LDK-në




Kosova rrezikon Presidentin? Kurti:
Absurde sjellja e 6 deputetëve të LDK



Hodhi gaz lotsjellës në Kuvend, gjykata
shpall fajtor ministrin në detyrë Xhelal
Sveçla

Latest Videos



Shtyhet sërish Censi i Bujqësisë: Nuk ka buxhet, do të
realizohet vitin e ardhshëm



"Pse nuk e shan Erion Veliajn njeri në Protestë? Frika e Edi
Ramës se i shkon te Sali Berisha"



Karakaçi inspekton punimet për bypassin e Elbasanit: I jep
zgjidhje trafikut



Goditet grupi shqiptar i kokainës, 8 të ndaluar në Belgjikë, i
përfshirë edhe Gerd Gjinarari

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulohet
Imagjinatë
Dëshmi



Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved

Mundësiuar nga Mediasat



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.